




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH. nr. 344 /19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “HAXHIJAJA” sh.p.k Rahovec kundër njoftimit për anulim e aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizimi i fermerëve me motokultivator-Ritenderim” me nr.prokurimi 611- 19-2753-1-2-1 të iniciuar nga AK-KK Glllogoc më datën 25.07.2019 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “HAXHIJAJA SHPK”- lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi i fermerëve me motokultivator-Ritenderim” me nr.prokurimi 611- 19-2753-1-2-1 të iniciuar nga AK- KK Glllogoc .

**II. ANULOHET**, vendimi i AK-së - Njoftimi për anulim e aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizimi i fermerëve me motokultivator-Ritenderim” me nr.prokurimi 611- 19-2753-1-2-1 të iniciuar nga AK-“KK Glllogoc dhe aktiviteti i prokurimit në fjale kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “HAXHIJAJA SHPK”- aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A R S Y E T I M**

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 03.05.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 28.05.19

Kundër njoftimit për anulim e aktivitetin të prokurimit, operatori ekonomik: “HAXHIJAJA SHPK”- me dt:14.06.19, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 17.06.19 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “HAXHIJAJA SHPK” si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “HAXHIJAJA SHPK” si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.06.2019 me nr. 344 / 19, kundër njoftimit për anulim e aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizimi i fermerëve me motokultivator-Ritenderim” me nr.prokurimi 611- 19-2753-1-2-1 të iniciuar nga AK- KK Gllogoc duke pretenduar në shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së:

- Shkelje e nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 6 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
- Shkelje e nenit 43 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,

Shkelje e nenit 44 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.07.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.



Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 09.07.2019, Lidhur me pretendimin e OE "HAXHIJAJA" SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka eliminuar ofertën e OE të lartcekur edhe pse si ofertë me e lirë me arsyetimin se OE "Haxhijaha" i mungon afati i liferimit të furnizimit me motokultivator dhe sipas OE ankues afati i liferimit nuk është kërkuar, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

AK "Gllogoc" në Dosjen e tenderit, konkretisht Tek pjesa e III "Kushtet e veçanta të kontratës" tek pika 11 AK ka specifikuar Furnizimi i FERMERVE duhet të bëhet në afat prej 60 ditësh nga nënshkrimi i kontratës që nënkupton se AK ka përcaktuar afatin maksimal për liferimin e pajisjeve të kërkuara me këtë aktivitet të prokurimit dhe OE pjesëmarrës në këtë aktivitet obligohen ti respektojnë të gjitha kërkesat nga dosja e tenderit.

OE pjesëmarrës në aktivitet të prokurimit në momentin e nënshkrimit/dërgimit përmes platformës elektronike formularit të tenderit dëshmojnë se kanë kontrolluar dhe pranojnë të gjitha kriteret/kërkesat dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Fakti që afati i liferimit është përcaktuar nga AK në kushtet e veçanta të kontratës nënkupton që OE nuk kanë pasur nevojë të dorëzojnë afatin e liferimit të pajisjeve në ofertën e tyre.

Afati i liferimit nuk është pjesë e poentimit apo vlerësimit të ofertave që do të ndikonte në përzgjedhjen e OE.

Konstatojmë se pretendimi ankimor është i bazuar

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të pranohet për arsyen që e theksuam në përgjigjen e pretendimit ankimor të më sipërm.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta kthejë në RIVLERËSIM aktivitetin e prokurimit "Furnizimi i fermerëve me motokultivator -Ritenderim" me nr.prokurimi 611-19-2753-1-2-1 të iniciuar nga AK- KK Gllogoc.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 10.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 09.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues profesional, përfaqësuesi i OE ankues, autoriteti kontraktues ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga:

autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues profesional, parashtrirat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Haxhijaha deklaroj: Kërkesa është bërë për shkak të afatit të liferimit, kjo ka qenë në pjesën e tretë tek pika 11. Ne me nënshkrim të formularit të tenderit dëshmojmë që kemi kontrolluar dhe jemi pajtuar me kushte të kontratës. Ngase afati i liferimit nuk është pjesë e kontratës.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së ankues z. Gllareva deklaroj: Komisioni i shqyrtimit ka propozuar që afati i liferimit nuk ka qenë i përcaktuar në mënyrë recidive në kërkesë në DT por komisioni vlerësues ka parë të arsyeshme që edhe ky element të jetë i domosdoshëm si kërkesë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Profesional Shqyrtues z. Papaj deklaroj: Tek pjesa e 3-të tek pika 11 është cekur furnizimi i fermerëve duhet të bëhet në afat prej 60 ditësh nga nënshkrimi i kontratës. Qëndrojmë prapa raportit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë që të aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkojmë që të hidhet poshtë ankesa e OE dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron ankesa e parashtruar nga ana e operatorit ekonomik "HAXHIJAH" shpk Rahovec, është kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizimi i fermerëve me motokultivator-Ritenderim" me nr.prokurimi 611-19-2753-1-2-1 të iniciuar nga AK-KK Glllogoc.

Lidhur me pretendimin e OE "HAXHIJAH" SHPK se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka eliminuar ofertën e OE të lartcekur edhe pse si ofertë me e lirë me arsyetimin se OE "Haxhijaha" i mungon afati i liferimit të furnizimit me motokultivator dhe sipas OE ankues afati i liferimit nuk është kërkuar. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se AK Glllogoc në Dosjen e tenderit, konkretisht Tek pjesa e III "Kushtet e veçanta të kontratës" tek pika 11 AK ka specifikuar Furnizimi i FERMERVE duhet të bëhet në afat prej 60 ditësh nga nënshkrimi i kontratës që nënkupton se AK ka



përcaktuar afatin maksimal për liferimin e pajisjeve të kërkuara me këtë aktivitet të prokurimit dhe OE pjesëmarrës në këtë aktivitet obligohen ti respektojnë të gjitha kërkesat nga dosja e tenderit.

OE pjesëmarrës në aktivitet të prokurimit në momentin e nënshkrimit/dërgimit përmes platformës elektronike formularit të tenderit dëshmojnë se kanë kontrolluar dhe pranojnë të gjitha kriteret/kërkesat dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Fakti që afati i liferimit është përcaktuar nga AK në kushtet e veçanta të kontratës nënkupton që OE nuk kanë pasur nevojë të dorëzojnë afatin e liferimit të pajisjeve në ofertën e tyre.

Afati i liferimit nuk është pjesë e poentimit apo vlerësimit të ofertave që do të ndikonte në përzgjedhjen e OE, andaj nga te cekura si më lart Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, si dhe vlerësimin e ofertave ta bëjë konform dispozitave të cekura si më lart si dhe konform nenit 56.3 të LPP-së, duke mos eliminuar asnjë ofertues për kërkesa të cilat nuk janë të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Nuh Paçarizi



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK - AK-KK Glllogoc

1x1 OE- HAXHIJAH SHPK-Rahovec

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.